KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

PROCESVERBAL IX/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IX (nëntë) për vitin 2026 të Komitetit për Komunitete Suharekë

Vendi: **KK Suharekë**
Zyra: **Salla e Bordit të Drejtorëve**
Data: **22.09.2026**
Ora : **09:00**

Prezentë:

Znj. Shkendije Shabanaj-Kryesuese
z.Nazim Shabanaj
znj.Merita Basha
z.Zek Berisha
znj.Amira Sofra
z.Aziz Bytyqi
z.Urim Suka

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesja e cila propozoi këtë:

Rend Dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit AUV-in;

5.Të ndryshme

Kryesuesja- i njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja-sugjeron që në procesverbal të përfshin pyetjet dhe rekomandimet të cilat i bën ajo.

Unanimisht miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesja-e elaboron pikën dhe hap debatin
Avni Bytyçi-përshendetje për të gjithë,këtu bëhet fjal për formimin e komisionit që ne para dy seancave patëm marr një vendim paraprak për dhënien ne shfrytëzim të një parcele dhe kur u dhen konfirmimi ligjshmëris nga Ministria ne po formojm komisionin që të vazhdojn procedurat më tutje.
Kryesuesja-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesja-e elaboron pikën dhe hap debatin
Avni Bytyçi-këtu bëhet fjalë për parcelën që është te deponia e mbeturinave në Shirokë konkretisht në Zonën Industriale,në vitin 2025 e kemi marr një vendim paraprak për me i zhvillu procedurat për me dhën në shfrytëzim për një periudh 5 vjeqare ashtu siq e kërkon edhe udhëzimi administrativ e kemi pas formu komisionin mirpo komisioni pat mbetur në procedur përshkak të shpalljes së zgjedhjeve nga Presidentja e Republikëë Kosovës,deri më tash Ekzekutivi nuk është marr me këtë çështjenëse nuk gaboj në mbledhjen e kalume te Asamblesë është ngritur si shqetësim dhe tani ka fillu procedura e formimit të komisionit përsëri për me i vazhdu procedurat.
Urim Suka-përshendetje për të gjithë,unë e pashë vendimin dhe mua më bëri përshtypje kjo vonesa e këtij vendimi dmth me 30 janar 2025 është dhën pëlqimi nga Kuvendi i Komunës për me u ndjek procedurat për këtë lënd ndërsa Presidentja zgjedhjet i ka shpall me 09/06/2025 gati mbas 6 muaj dhe po mendoj që komisioni ka pas koh të mjaftueshme për 6 muaj me kry komisioni punen e vet para se me u shpalll zgjedhjet përtej ksaj është e quditshme se mbas 1 viti që është bë mandati i ri që prap është neglizhu kjo pun dhe po du me dit nëse mundet dikush mem tregu pse ka ndodh kjo vones për një pëlqim që është dhen me herët dhe pse e kan leju me punu në mënyr të pa ligjshëme.
Kryesuesja-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit AUV-in;

Kryesuesja-e elaboron pikën dhe hap debatin
Avni Bytyçi-këtu bëhet fjal për një kërkesë të AUV-it që kan kërku vazhdimisht me caktu një lokacion Komuna për çështjet e gjedheve që ngordhin,dhe ne kemi inicu proceduren për me caktu një lokacion dhe ne i kemi nda 10 h nga parcela te varrezate e reja të Qytetit,mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e ksaj ka me bë Agjencioni.
Urim Suka-habitem edhe këtu pse me u detyru Agjencioni me i bë 3 kërkesa Kryetarit dhe unë mendoj që kjo qështje është emergjente kur ka kafsh që jan të infektuara duhet me u trajtu për mos me u leju me u përhap ndonjë epidemi.
Kryesuesja-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5.Të ndryshme;

Kryesuesja-nuk ka pas çështje të ngritura.

Takimi përfundoi: 09:10